

KËRKESË
Nr. 959, datë 6.11.2025

**PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS
“EKSPERTIZË E JASHTME PËR MONITORIMIN E PËRMIRËSUAR,
MENAXHIMIN E TË DHËNAVE, NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR
PERFORMANCËN OPERACIONALE DHE FINANCIARE, SI DHE
MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E TRANZICIONIT DREJT EKONOMISË
QARKULLUESE”**

Shteti: **Shqipëri**

Emri i Projektit: **Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu (Care4BlueSea)**

Nr. i Huas: **95070-AL**

Nr. i ID-së së Projektit: **P176163**

Titulli i detyrës: **Ekspertizë e jashtme për monitorimin e përmirësuar, menaxhimin e të dhënave, ngritjen e kapaciteteve për performancën operationale dhe financiare, si dhe mbështetje për zbatimin e tranzicionit drejt ekonomisë qarkulluese**

Nr. reference: **AL-MTE-1.1.1-1.1-CS-QCBS**

Ministria e Mjedisit ka siguruar financim nga Banka Botërore për iniciativën Care4BlueSea dhe synon të përdorë një pjesë të këtij financimi për shërbime konsulence.

Shërbimet e konsulencës përfshijnë asistencën teknike për bashkitë në Zonën e Mbetjeve Gjirokastër–Vlora Jug, me qëllim forcimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane (MSWM) dhe mundësimin e kalimit drejt një ekonomie qarkulluese. Mbështetja fokusohet në: i. menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave (sisteme, protokolle, tregues dhe verifikim të përafruar me EPBI); ii. ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin institucional (program trajnimesh, mjete dhe hartim të planit bashkiak të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kuadrin shqiptar/BE dhe Manualin EPBI); iii. mbështetjen e zbatimit të masave për ekonominë qarkulluese (sisteme të grumbullimit të diferencuar, planifikim investimesh, mbështetje për VNM strategjike); dhe iv. qëndrueshmërinë financiare (kosto, tarifa, përmirësim të faturimit/arkëtimit, tregues kryesorë të performancës (KPI) dhe udhëzim për kontraktim të bazuar në performancë).

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj detyre është të vendosen praktika moderne dhe të orientuara nga të dhënat për Planeve të Integruara të Menaxhimit të Mbetjeve të Bashkive, që përmbushin Kushtet Minimale të Aksesit (MAC) të EPBI të nivelit 1 dhe 2 dhe direktivat e BE-së, si dhe të ndërtohen kapacitete të qëndrueshme bashkiake (në planifikim, operim, monitorim dhe financë) për të përmirësuar performancën e shërbimit dhe rritjen e metodave të ekonomisë qarkulluese.

Bashkitë target janë bashkitë e zonës së jugut Gjirokastër–Vlorë (Delvinë, Himarë, Finiq, Konispol, Sarandë, Dropull, Gjirokastër, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet, Tepelenë). Puna në terren dhe trajnimi do të zhvillohen nëpër këto bashki; sipas nevojës do të ketë edhe koordinim me agjencitë qendrore në Tiranë. Periudha e Zbatimit është **36 muaj** nga nënshkrimi i kontratës.

Ministria e Mjedisit fton tani firmat e kualifikuara konsulente (“Konsulentët”) të shprehin interesin e tyre për ofrimin e shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të paraqesin informacion që demonstroi se ata zotërojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën e duhur për kryerjen e shërbimeve.

Konsulentët duhet të plotësojnë kërkesat minimale të mëposhtme:

a) Të jenë entitete të regjistruara, me përvojë si ofrues shërbimesh asistencë teknike në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, për të paktën 5 vjetët e fundit;

b) Të kenë përvojë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimit, që përfshijnë aspekte si qeverisja, buxheti dhe menaxhimi i të dhënave;

c) Të kenë hartuar me sukses plane të menaxhimit të mbetjeve në të paktën 3 bashki/njësi të qeverisjes vendore;

d) Firma duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor që kombinon ekspertizën në inxhinieri mjedisore, planifikim të menaxhimit të mbetjeve, projektim të shërbimeve me bazë GIS, kuadër ligjor dhe politikash, si edhe përgatitje trajnimesh.

Kriteret e përzgjedhjes paraprake janë:

NR.	KRITERI I VLERËSIMIT	PIKËT
1.	Përvoja e përgjithshme e firmës/vitet e konsulentit në treg	30 pikë
2.	Përvoja specifike përkatëse në detyra të ngjashme	60 pikë
3.	Disponueshmëria e stafit brenda firmës për kryerjen e detyrës	10 pikë
TOTAL		100 pikë

Vëmendja e Konsulentëve të interesuar tërhiqet te seksioni III, paragrafët 3.13, 3.15 dhe 3.16 të “Rregulloreve të Prokurimit për Huamarrësit e IPF” të Bankës Botërore, të shtatorit 2025 (“Rregulloret e Prokurimit”), ku përcaktohet politika e Bankës Botërore mbi konfliktin e interesit.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse bashkimi është në formën e një bashkimi të përbashkët (*joint venture*) dhe/ose nënkonsulence. Në rast bashkimi të përbashkët, të gjithë partnerët në bashkim do të jenë përgjegjës, së bashku dhe veç e veç, për të gjithë kontratën, nëse përzgjidhen.

Një Konsulent do të përzgjidhet në përputhje me metodën e përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe kostos (QCBS), të përcaktuar në Rregulloret e Prokurimit.

Për informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni në adresën më poshtë gjatë orarit zyrtar 09:00–16:00, nga e hëna në të enjte, dhe 09:00–13:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë, me faks ose me *e-mail*) deri më **25 nëntor 2025, ora 16:30, me orën lokale**.

Për më shumë informacion, Konsulentët e interesuar mund të gjejnë termat e referencës të bashkëngjitur.

Ministria e Mjedisit

Mjedis i Pastër dhe me Aftësi Ripërtëritëse për Detin Blu (Care4BlueSea)

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1

1001 Tiranë, Shqipëri

Attn: Znj. Ledina Beqiraj Agalliu

Sekretare e Përgjithshme

E-mail: ledina.beqiraj@mjedisi.gov.al

Attn: Znj. Artenida Duraku

E-mail: artenida.duraku@mjedisi.gov.al

TERMAT E REFERENCËS

PËR ASISTENCË TEKNIKE PËR MONITORIMIN E PËRMIRËSUAR,
MENAXHIMIN E TË DHËNAVE, NGRITJEN E KAPACITETEVE PËR
PERFORMANCËN OPERACIONALE DHE FINANCIARE, SI DHE MBËSHTETJE PËR
ZBATIMIN E TRANZICIONIT DREJT EKONOMISË QARKULLUESE PËR
PROJEKTIN MJEDIS I PASTËR DHE ME AFTËSI RIPËRTËRITËSE PËR DETIN BLU

I. Sfondi i Projektit

Për të mbështetur zbatimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve dhe për t’u siguruar që qasja rajonale e menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake (MSWM) të funksionojë sa më efektivisht dhe me efikasitet sa më të lartë, Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore kanë

lancuar projektin “Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse për detin blu” (Care4BlueSea). Projekti synon të zbatojë një qasje të integruar të ekonomisë blu, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel lokal, duke u fokusuar në zona të përzgjedhura gjeografike me vlera të larta detare dhe bregdetare, të cilat janë nën presione mjedisore dhe klimatike. Care4BlueSea përbëhet nga tre komponentë: i. Komponenti 1: Promovon qasje të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit; ii. Komponenti 2: Synon të ulë ndotjen e ujit në lumin Vjosë; dhe iii. Komponenti 3: Mbulon nevojat për menaxhimin e projektit, dhe monitorimin, dhe vlerësimin.

Projekti ndjek një qasje të integruar për parandalimin në burim të ndotjes së shkaktuar nga mbetjet e ngurta bashkiake dhe ujërat e ndotura. Dyfishi i fokusit tek investimet në mbetjet e ngurta dhe ujërat e ndotura përfaqëson linjën e parë të mbrojtjes ndaj presioneve mbi trupat ujorë dhe peizazhet bregdetare nga të cilat varet ekonomia vendore. Sinergjitë midis këtyre investimeve forcojnë rezultatet e përpjekjeve për parandalimin e ndotjes. Përfitimet e mundshme të përbashkëta të menaxhimit të mbetjeve të ngurta (SWM) dhe trajtimit të ujërave të ndotura përfshijnë: parandalimin e bllokimit të kanalizimeve, bashkëtrajtimin ose kompostimin e materies organike, si dhe ripërdorimin e llumit si përmirësues të tokës për mbulimin dhe mbylljen e venddepozitimeve të mbetjeve. Aktivitetet e planifikuara janë të përafruara me standardet teknike dhe direktivat e Bashkimit Evropian (BE) – Direktivën për Mbetjet dhe Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane – duke forcuar përpjekjet e Shqipërisë drejt objektivave të anëtarësimit në BE, veçanërisht në rritjen e qarkullueshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së ujit.

Palët kryesore institucionale të interesuara janë Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), të cilat do të bashkëpunojnë ngushtësisht edhe me katër partnerë kyç: a) Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për komponentin 1; b) Drejtoria Rajonale e Shqipërisë të Ujësjellës-Kanalizimeve për komponentin 2; c) Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) për komponentin 2; dhe d) bashkitë për të tre komponentët, pasi pritet të përfitojnë nga menaxhimi më i mirë i mbetjeve të ngurta dhe i shërbimeve sanitare, nga monitorimi dhe mjedisi i përmirësuar i planifikimit, nga një kuadër i përmirësuar rregullator për qëndrueshmëri operationale dhe financiare, si dhe nga ngritja e kapaciteteve dhe trajnimet.

Përfituesit institucionalë përfshijnë drejtpërdrejt ofruesit e shërbimit (ujësjellës-kanalizime dhe ndërmarrjet e menaxhimit të mbetjeve) në nivel bashkie, si dhe klientët e tyre, të cilët do të përfitojnë në mënyrë indirekte nga përmirësimet në performancën operationale dhe efikasitetin që do të arrihen në kuadër të projektit.

Nga aktivitetet e projektit, vlerësohet se rreth 138 800 persona (5 për qind e popullsisë së Shqipërisë) do të përfitojnë nga përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe shërbimeve sanitare. Rreth 87 000 përfitues në bashki të përzgjedhura do të përjetojnë përmirësim të menaxhimit të mbetjeve të ngurta, përfshirë përmirësimin e grumbullimit, ndarjes dhe riciklimit të mbetjeve bashkiake, ndërsa rreth 51 800 përfitues do të fitojnë akses në shërbime të reja ose të përmirësuara sanitare. Për më tepër, vlerësohet se rreth 200 individë do të përfitojnë nga praktikat e menaxhimit të tokës të synuara për të parandaluar rrjedhjet sipërfaqësore dhe ndotjen në lumin Vjosë dhe degët e tij. Po ashtu, pritet që edhe organizatat e shoqërisë civile të përfitojnë nga zbatimi i këtyre nismave dhe të angazhohen si promotore të një mjedisi më të pastër në Brezin Bregdetar Jug-Perëndimor.

Gjithashtu, turistët që vizitojnë lumin Vjosë dhe vijën bregdetare të vendit pritet të përfitojnë nga një vijë bregdetare dhe zona natyrore më të pastra, falë ndërhyrjeve të projektit. Menaxhimi efektiv i mbetjeve të ngurta në nivel qyteti do të kontribuojë në reduktimin e mbetjeve detare, duke sjellë efekte të gjera, si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Në kuadër të nënkomponentit 1.1 të komponentit 1, Ministria e Mjedisit synon të përmirësojë mjedisin mundësues për qëndrueshmëri operationale dhe një qasje më qarkulluese në menaxhimin e mbetjeve. Kjo do të arrihet përmes asistencës teknike dhe mbështetjes së kapaciteteve për mbushjen e boshllëqeve specifike teknike për zbatimin efektiv të politikave të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. MoTE do të lançojë një program Investimesh Mjedisore të

Bazuara në Performancë në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake (MSWM EPBI) në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (WZ), e cila mbetet dukshëm prapa mesatareve kombëtare të performancës në menaxhimin e mbetjeve, siç tregohet nga një normë mesatare grumbullimi prej vetëm 66% në vitin 2021. Duke pasur parasysh pozicionimin mjedisor të WZ, boshllëqet në performancën e MSWM-së kanë çuar në ndotje të ujit, e cila kërcënon shëndetin e ekosistemeve detare dhe bregdetare, ndikon negativisht në turizëm dhe shkakton humbje të konsiderueshme ekonomike të lidhura me peshkimin.

Duke u ofruar bashkive, investime kritike të bazuara në performancën e tyre në MSWM, programi EPBI synon të ndërtojë një sistem më të qëndrueshëm të menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe të lehtësojë përmirësimet në ofrimin e shërbimit, edhe pse kostot operative rriten nën qasjen më rajonale të MSWM-së. EPBI-ja fokusohet në MSWM, pasi ky lloj mbetjesh renditet ndër kërcënimet më të mëdha për zonën e mbrojtur të lumit Vjosë.

Më konkretisht, projekti Care4BlueSea do të mbështesë bashkitë e Zonës së Mbetjeve Gjirokastrë–Vlorë Jug (WZ) dhe dizajni i projektit përmban tre komponentë:

Komponenti 1: Promovimi i qasjeve të integruara dhe qarkulluese për mbrojtjen e peizazheve dhe burimeve të ujit

Ky komponent do të mbështesë zbatimin e zgjidhjeve lokale për mbrojtjen e peizazheve të vlefshme dhe burimeve të ujit brenda Zonës së Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë (shih hartën e WZ-së në shtojcë). Projekti aplikon një qasje të integruar për investimet në SWM, duke marrë në konsideratë parimet e ekonomisë qarkulluese, dhe mbështet ngritjen e një sistemi më të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore, financiare dhe operacionale. Rezultatet e këtyre aktiviteteve janë sinergjike me ato të komponentit 2 për ujërat dhe kanalizimet. Ky komponent do të financojë shërbime konsulence, shërbime jokonsulence, mallra dhe trajnime.

- Nënkomponenti 1.1: Mbështetje institucionale për performancë të qëndrueshme, monitorim të përmirësuar dhe tranzicion drejt ekonomisë qarkulluese

Ky nënkomponent synon të përmirësojë mjedisin mundësues për qëndrueshmëri operacionale dhe një qasje më qarkulluese në menaxhimin e mbetjeve. Kjo do të arrihet përmes asistencës teknike dhe mbështetjes së kapaciteteve për mbushjen e boshllëqeve specifike teknike për zbatimin efektiv të politikave të menaxhimit të mbetjeve të ngurta. Do të financohen aktivitetet e mëposhtme:

i. Ofrimi i mbështetjes teknike për menaxhimin e të dhënave dhe monitorimin e performancës së menaxhimit të mbetjeve të ngurta, duke përfshirë:

- a) mbështetjen për sistemet e menaxhimit të të dhënave dhe verifikimit në nivel bashkie;
- b) monitorimin e performancës dhe zhvillimin e një mekanizmi zbatimi (*enforcement*) për aktivitetet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake; dhe
- c) rritjen e kapaciteteve të performancës, përfshirë trajnimin, për bashkitë e pranueshme, për të siguruar mjedisin mundësues për menaxhimin dhe zbatimin e investimeve mjedisore të bazuara në performancë (EPBI) të financuara në nënkomponentin 1.2;

ii. Kryerjen e një studimi mbi qëndrueshmërinë financiare dhe ofrimin e ngritjes së kapaciteteve të lidhura (p.sh.: rikuperimi i kostove, përcaktimi dhe mbledhja e tarifave, menaxhimi i kontratave) në nivel bashkie;

iii. Mbështetjen për MoTE-n dhe bashkitë për:

- a) zbatimin e përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR) (p.sh.: mbështetje në leje, raportim, monitorim); dhe
- b) përditësimin dhe/ose zhvillimin e kuadrit rregullator për menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, përfshirë standardet për materialet dhe menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit/inertëve.

- Nënkomponenti 1.2: Investime të bazuara në performancë mjedisore për parandalimin e ndotjes lokale

Ky nënkomponent do të financojë EPBI-në për bashkitë në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve bashkiake. Bashkitë do të përfitojnë investime vendore kundrejt përmirësimeve të matshme dhe të qëndrueshme në grumbullimin e mbetjeve të ngurta, rritjen e riciklueshmërisë dhe/ose rikuperimin e kostove. Këto investime

vendore do të mbështesin ndryshimin e sjelljes për hapësira urbane më të pastra dhe më të gjelbra dhe ekosisteme bregdetare e ujore më të shëndetshme. Bashkitë do të bëhen të pranueshme për t'u përfshirë në EPBI në bazë të performancës së tyre të mëparshme, përveç kritereve të tjera. Përshtatshmëria e bashkive, prioritarizimi dhe modalitetet e zbatimit të këtij aktiviteti janë të detajuara më tej në manualin EPBI, i cili do t'i vihet në dispozicion Konsulentit pas nënshkrimit të kontratës.

Për të siguruar mjedisin e përshtatshëm mundësues për bashkitë, në mënyrë që ato të arrijnë përmirësime në performancë përmes EPBI, projekti do të mbështesë një sërë investimesh paraprake gjatë dy viteve të para të zbatimit të projektit. Këto investime do të përbëhen nga: pajisje për të mbështetur sistemin e monitorimit të bashkive; furnizimi me pajisje dhe automjete për grumbullimin e mbetjeve dhe ndarjen në burim; si dhe furnizimi me pajisje për qendrat e riciklimit.

- Nënkomponenti 1.3: Mbështetje për ndryshimin e sjelljes dhe diseminimin për shkallëzim

Ky nënkomponent do të zhvillojë aktivitete të menaxhimit të njohurive (të tilla si përgatitja dhe diseminimi i mësimëve të nxjerra nga EPBI për një shkallëzim të mundshëm në nivel kombëtar), fushata të rritjes së ndërgjegjësimit publik, përfshirë fushata komunikimi në shkolla mbi menaxhimin e përmirësuar të mbetjeve, ndarjen e mbetjeve, shërbimet e ujit dhe kanalizimeve, si dhe menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit, në nivel kombëtar. Këto fushata do të komunikojnë për shërbimet e përmirësuara të menaxhimit të mbetjeve bashkiake dhe të ujit dhe kanalizimeve, për të mbështetur pranimin e nivelit të tarifave të lidhura me ofrimin e shërbimit. Për të mbështetur ndryshimin e sjelljes për ndarjen në burim dhe riciklimin e plastikës në zona me popullsi dhe turizëm të lartë, projekti do të instalojë kontejnerë kompaktone diellorë (*solar compaction bins*) në Zonën e Mbetjeve Vlorë Jug–Gjirokastrë.

II. Qëllimi

Qëllimi i kësaj detyre është të ofrojë mbështetje të Asistencës Teknike për bashkitë e synuara të Zonës së Mbetjeve Gjirokastrë–Vlorë Jug (përkatësisht Delvinë, Himarë, Finiq, Konispol, Sarandë, Dropull, Gjirokastrë, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj, Përmet dhe Tepelenë), me synim forcimin e sistemeve të tyre të menaxhimit të mbetjeve të ngurta bashkiake dhe lehtësimin e tranzicionit drejt një ekonomie qarkulluese. Detyra do të fokusohet në tre fusha kyçe: a) menaxhimin dhe monitorimin e të dhënave; b) ngritjen e kapaciteteve; dhe c) zbatimin e masave të “ekonomisë qarkulluese”.

Kjo detyrë synon jo vetëm të adresojë boshllëqet ekzistuese në bashkitë ku do të zbatohet projekti, por edhe të vendosë një model modern, të bazuar në të dhëna dhe qarkullues të menaxhimit të mbetjeve, që do t'i mundësojë çdo bashkie të pranueshme të përmbushë si kushtet minimale të aksesit të niveli 1 (*Tier 1*), ashtu edhe ato të niveli 2 (*Tier 2*), në përgatitje të çdo cikli EPBI, siç përcaktohet në manualin EPBI.

Detyra do të zbatohet nga një shoqëri konsulence (në vijim “Konsulenti”) me ekspertizë të provuar në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale, duke punuar në koordinim të ngushtë me autoritetet vendore, agjencitë rajonale dhe palët e interesuara në komunitet.

III. Përshkrimi i detyrës dhe detyrat kryesore

Gjatë kryerjes së shërbimeve të tij, Konsulenti do të bashkërendojë punën me institucionet e ngritura të projektit, përkatësisht PMT-në e Care4BlueSea pranë Ministrisë së Mjedisit, grupet politike dhe teknike të punës në bashkitë e angazhuara, si dhe me projekte të tjera të financuara nga burime vendëse dhe të huaja që janë në zbatim në zonën e synuar.

Konsulenti do të jetë përgjegjës për përmbajtjen, hartimin e materialeve dhe dorëzimin e paketës së asistencës teknike në fushat e përmendura më poshtë:

A. Menaxhimi i të dhënave

Konsulenti do të:

1. Të vlerësojë sistemet ekzistuese të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për mbetjet në bashki, duke identifikuar boshllëqet, mospërputhjet dhe fushat për përmirësim, në përputhje me VKM-në nr. 538/2021 dhe standardet e BE-së.

2. Të zhvillojë dhe zbatojë protokolle për mbledhjen e rregullt të të dhënave nga bashkitë, të përafruara me metodologjitë e përcaktuara në VKM-në nr. 538/2021, duke marrë në konsideratë çdo ndryshim të mundshëm të VKM-së, veçanërisht për kategoritë e mbetjeve dhe burimet e të dhënave, përfshirë flukset e mbetjeve bashkiake, tregtare, ndërtimore, të rrezikshme dhe të riciklueshme.

3. Bazuar në analizën e manualit EPBI, të zhvillojë sisteme në nivel terreni për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, që do të përdoren nga stafi bashkiak i angazhuar në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve.

4. Të mbështesë bashkitë në përpilimin dhe dorëzimin e raporteve vjetore të statistikave të mbetjeve deri më 31 janar të çdo viti pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM/NEA) dhe Agjencisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve (AKEM), duke siguruar pajtueshmëri të plotë me detyrimet e raportimit sipas VKM-së nr. 538/2021.

5. Të mbështesë AKEM-në dhe AKM-në, duke ofruar rekomandime për hartimin e një kuadri për raportimin e të dhënave për mbledhjen e të dhënave nga bashkitë dhe përgatitjen e raportit kombëtar të monitorimit.

6. Të hartojë një kuadër monitorimi me tregues performance të përafruar me Direktivën Kornizë të BE-së për Mbetjet dhe Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese (p.sh.: norma e devijimit nga venddepozitimi, norma e grumbullimit të veçuar, norma e riciklimit sipas flukseve materiale), të lidhur me efektivitetin e pjesëmarrjes në EPBI për çdo bashki.

B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional

Konsulenti do të përgatisë dhe zhvillojë paketën e ngritjes së kapaciteteve, do të dorëzojë trajnimet dhe kurrikulën e forcimit institucional. Kurrikula e ngritjes së kapaciteteve duhet të ndërtohet mbi eksperiencën e kurrikulës së programit “Bashki të forta”. Punëtoritë e ngritjes së kapaciteteve do të mbulojnë fusha kryesore tematike, si më poshtë:

1. Bazuar në një analizë të detajuar të manualit EPBI, si dhe tërësisë së kuadrit ligjor kombëtar – përfshirë edhe projektligjin e ri për “Menaxhimin e integruar të mbetjeve” – Konsulenti duhet të zhvillojë dhe të dorëzojë një paketë gjithëpërfshirëse të Asistencës Teknike për Bashkitë pjesëmarrëse, me synim krijimin e qartësisë së plotë institucionale, kapaciteteve operacionale dhe gatishmërisë procedurale në të gjitha bashkitë pjesëmarrëse, për të siguruar zbatim efektiv, transparent dhe të qëndrueshëm të EPBI-së, si nga perspektiva e pajtueshmërisë ligjore, ashtu edhe e menaxhimit të performancës. Kjo paketë duhet të përfshijë, minimalisht:

- Materiale të detajuara trajnimi, të dizajnuara posaçërisht për të siguruar që stafi bashkiak të kuptojë plotësisht funksionimin operativ të mekanizmit EPBI (mekanizmi i stimujve të bazuar në performancën mjedisore);

- Sisteme praktike, mjete dhe protokolle për mbledhjen e saktë të të dhënave dhe raportimin sistematik të treguesve përkatës të performancës;

- Një kalendar të qartë të punëtorive dhe sesioneve të trajnimit, të mbështetur nga një plan trajnimi i strukturuar, që mundëson ngritje graduale të kapaciteteve të bashkive;

2. Trajnimet do të vendosin theks të veçantë në ofrimin e udhëzimit të thelluar praktik, në mënyrë që bashkitë pjesëmarrëse të fitojnë një kuptim të plotë institucional dhe gatishmëri të plotë për zbatimin e EPBI. Kjo përfshin:

- Si do të matet në mënyrë objektive performanca e tyre kundrejt treguesve të performancës të EPBI-së?

- Çfarë lloji të dhënash duhet të mblidhen, në çfarë formatesh dhe si duhet të raportohen ato tek organet përkatëse?

- Si do t'u nënshtrohen të dhënat e dorëzuara proceseve të verifikimit dhe vlefshmërisë?

- Si do të ndikojnë drejtpërdrejt rezultatet e performancës në llogaritjen e shpërblimeve nën sistemin EPBI, me shpjegime transparente të metodologjisë së përdorur për përcaktimin e stimujve financiarë ose të tjerë?

- Si do të alokohen dhe shpërndahen shpërblimet bazuar në rezultatet e verifikuara?

3. Të zhvillojë/përditësojë Planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik shqiptar dhe legjislacionin e BE-së, bazuar në shqyrtimin dhe analizën e manualit EPBI;

4. Të rishikojë kuadrin ligjor shqiptar dhe atë të BE-së, si dhe planet strategjike rajonale dhe vendore që lidhen me ekonominë qarkulluese dhe sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Të mbledhë, përpunojë dhe analizojë të dhënat që lidhen me sasinë dhe përbërjen e mbetjeve, infrastrukturën aktuale (kontejnerë, mjete), mbulimin e shërbimit dhe pikat kritike mjedisore (*hotspots*);

5. Të përgatisë projeksione që lidhen me madhësinë e popullsisë dhe sasinë e mbetjeve, me fokus planifikimin e ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbetjeve, për rritjen e bashkëpunimit ndërbashkiak dhe ndërrajonal;

6. Të sigurojë digjitalizimin dhe përpunimin e të dhënave duke përdorur Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), për rritjen e efikasitetit të ofrimit të shërbimit;

7. Të trajtojë menaxhimin financiar lokal që lidhet me menaxhimin e mbetjeve, me fokus llogaritjen e kostove, përcaktimin e tarifave, identifikimin e burimeve të financimit dhe ngritjen e një sistemi monitorimi;

8. Të nxisë përfshirjen e palëve të interesuara dhe pjesëmarrjen publike, me synim rritjen e vendimmarrjes pjesëmarrëse në sektorin e menaxhimit të mbetjeve;

9. Të promovojë konceptet e ekonomisë qarkulluese dhe zbatimin e tyre në përputhje me planet e veprimt të BE-së për ekonominë qarkulluese;

10. Të mbështesë monitorimin e mbetjeve detare përmes përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve në tokë;

11. Të trajtojë në menaxhimin, përpunimin dhe monitorimin e të dhënave që lidhen me menaxhimin e mbetjeve;

Konsulenti do të jetë përgjegjës për zhvillimin e përmbajtjes dhe dorëzimin e trajnimeve në përputhje me planin e miratuar të trajnimit, i cili është zhvilluar mbi bazën e kërkesave të përgjithshme për asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh të përcaktuara në manualin e zbatimit të Projektit.

C. Mbështetje për zbatimin e tranzicionit të bashkive drejt ekonomisë qarkulluese

Konsulenti do:

- Të zhvillojë ose të përditësojë planet lokale të menaxhimit të mbetjeve (PMMB/WMPs) për bashkitë pjesëmarrëse, plotësisht të përafruara me parimet e ekonomisë qarkulluese dhe direktivat e BE-së, duke përfshirë hierarkinë e mbetjeve, parandalimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin;

- Të kryejë vlerësime bazë në nivel bashkie për të hartëzuar tendencat aktuale të gjenerimit të mbetjeve, flukset e materialeve, mbulimin e grumbullimit dhe infrastrukturën ekzistuese të trajtimit;

- Të sigurojë integrimin e treguesve të ekonomisë qarkulluese në mjetet lokale të planifikimit dhe monitorimit, si p.sh.: përqindja e mbetjeve bashkiake të ricikluara; përqindja e mbetjeve organike të mbledhura veçmas dhe të kompostuara; përqindja e mbetjeve të devijuara nga venddepozitimi;

- Të identifikojë boshllëqet infrastrukturore dhe të propozojë nevojat për investime, si p.sh.: kosha dhe kontejnerë për ndarjen në burim (mbetje organike, plastikë, letër, qelq etj.); automjete grumbullimi (kamionë me sisteme shumëkompartimentëshe ose për trajtimin e mbetjeve organike); impiante të ndarjes, kompostimit dhe qendra për rikuperimin e materialeve (MRFs); qendra depozitimi (*drop-off*) dhe qendra ripërdorimi;

- Të projektojnë sisteme lokale për grumbullimin e veçuar të mbetjeve, të përshtatura me kontekstin urban/rural, dendësinë e vendbanimeve dhe modelet ekzistuese të shërbimit;

- Të hartojë modele të llogaritjes së kostove dhe përcaktimit të tarifave, bazuar në kuadrin rregullator kombëtar, në bashkëpunim me bashkitë pjesëmarrëse, në përputhje me kostot e ofrimit të shërbimit për strategjinë e propozuar të menaxhimit të mbetjeve, dhe të zhvillojë një politikë tarifimi për MSWM-në, që i mundëson bashkisë të mbulojë kostot mbi parimin e “mbulimit të kostove”;

- Të përgatisë mjete dhe mekanizma komunikimi për periudhën e zbatimit të planeve.

Të përgatisë planet e investimeve për projektet infrastrukturore prioritare, si p.sh.: impiante për reduktimin e mbetjeve, qendra për rikuperimin e materialeve (MRFs etj., duke marrë në konsideratë kosto-efektivitetin, efikasitetin operacional dhe performancën mjedisore).

Të mbështesë përgatitjen e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM/SEA) për planet e menaxhimit të mbetjeve bashkiake. VSM-ja duhet të vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore të PMMB-ve dhe të sigurojë që konsideratat e qëndrueshmërisë të integrohen në procesin e planifikimit.

D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të menaxhimit të mbetjeve të ngurta

Për të mbështetur bashkitë në ndërtimin e sistemeve të qëndrueshme të menaxhimit të mbetjeve të ngurta (SWM), Konsulenti do të ofrojë asistencë teknike të fokusuar në përmirësimin e planifikimit financiar, rikuperimin e kostove dhe gjenerimin e të ardhurave vendore.

Detyrat kryesore përfshijnë:

- Të kryejë vlerësime bazë financiare të SWM në çdo bashki (struktura e kostove, shpërndarja e shpenzimeve, treguesit e efikasitetit të kostove);

- Të analizojë burimet e të ardhurave dhe boshllëqet në rikuperimin e kostove, përfshirë tarifën, buxhetet bashkiake dhe transfertat fiskale;

- Të rishikojë kuadrin dhe praktikën e përcaktimit të tarifave; të propozojë modele tarifimi të bazuara në kosto, duke marrë parasysh përballueshmërinë dhe barazinë sociale;

- Të vlerësojë dhe përmirësojë sistemet e faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave; të prezantojë mjete për monitorimin dhe ndjekjen financiare;

- Të zhvillojë sesione trajnimi mbi buxhetimin, planifikimin financiar, përcaktimin e tarifave dhe menaxhimin e të ardhurave në sektorin e SWM-së;

- Të zhvillojë tregues të performancës financiare dhe t'i integrojë ata në monitorimin e EPBI-së dhe në kriteret e pranueshmërisë;

- Të ofrojë udhëzime mbi kontraktimin e bazuar në performancë dhe qeverisjen financiare për shërbimet e eksternalizuara të menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

IV. Kualifikimet dhe eksperiencat e Konsulentit

Shoqëria konsulente duhet të demonstrojë kapacitet të fortë institucional dhe eksperiencë të rëndësishme në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, me fokus në planifikimin bashkiak, forcimin institucional dhe dorëzimin e trajnimeve.

Shoqëria duhet të ketë një kuptim të mirë të kuadrit ligjor dhe institucional shqiptar për menaxhimin e mbetjeve, si dhe eksperiencë të provuar në mbështetjen e bashkive për përgatitjen e planeve të menaxhimit të mbetjeve bashkiake, ose dokumenteve të ngjashme strategjike. Eksperiencat e demonstruar në lehtësimin e proceseve pjesëmarrëse të planifikimit, dorëzimin e aktiviteteve të ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimin e mjeteve praktike dhe materialeve të trajnimit është thelbësore.

Shoqëria konsulente duhet të përmbushë kërkesat minimale të mëposhtme:

- a) Të jetë person juridik i regjistruar, me eksperiencë si ofrues shërbimesh Asistence Teknike (TA) në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta gjatë 5 vjetëve të fundit;

- b) Të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve që përfshijnë aspekte të tilla, si qeverisja, buxheti dhe menaxhimi i të dhënave;

c) Të ketë hartuar me sukses plane menaxhimi të mbetjeve në të paktën 3 bashki/njësi të qeverisjes vendore;

d) Shoqëria duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor që kombinon ekspertizë në inxhinierinë mjedisore, planifikimin e menaxhimit të mbetjeve, projektimin e shërbimeve në bazë të GIS-së, kuadrot ligjore dhe të politikave, si dhe lehtësimin e trajnimeve.

Shoqëria konsulente do të angazhojë për këtë detyrë ekspertët e mëposhtëm.

	Pozicioni i ekspertit	Nr. i ekspertëve	Kualifikime dhe eksperiencia	Detyrat që do të performohen
1.	Team leader/ Menaxher Projekti	1	- Diplomë Master në Inxhinieri Mjedisore ose Shkenca Mjedisore, Biznes, Ekonomi ose ekuivalente. - Minimumi dhjetë vjet eksperiencë të veçantë/të kombinuar në menaxhim projektesh/qeverisje vendore. - Minimumi 5 vjet eksperiencë në ofrimin e Asistencës Teknike (TA) në menaxhimin e mbetjeve të ngurta ose funksione të tjera të ofrimit të shërbimeve në nivel qeverisje vendore. - Eksperiencë në drejtimin e ekipeve me të paktën 5 persona. - Eksperiencë me institucionet qendrore kombëtare dhe Agjencitë Ndërkombëtare të Bashkëpunimit për Zhvillim, Bankën Botërore dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFIs). - Duhet të ketë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe raportimi në gjuhën angleze.	- Përgjegjësi për menaxhimin e kontratës. - Caktimi i stafit dhe i detyrave të tyre specifike - Mbajtja e komunikimit me të gjithë palët e përfshira. - Pjesëmarrja në takimet drejtuese dhe raportimi direkt tek autoritetet. - Hartimi i dokumenteve dhe mjeteve kryesore, si dhe paketave të ngritjes së kapaciteteve. - Reagimi ndaj ndryshimeve në projekt dhe adresimi i zhvillimeve të reja.
2.	Ekspert për ngritjen e kapaciteteve	1	- Diplomë Master në Inxhinieri Mjedisore, Shkenca Mjedisore ose në fusha të afërta. - Minimumi 3 vjet eksperiencë të veçantë/të kombinuar në menaxhim projektesh/aktivitete trajnimi dhe ngritje kapacitetesh. - Minimumi 3 vjet eksperiencë në projektimin dhe zbatimin e trajnimeve për ngritje kapacitetesh në fushën e menaxhimit të mbetjeve. - Eksperiencë e provuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, zhvillimin e materialeve të trajnimit dhe dorëzimin e punësive ose trajnimeve teknike për bashki, shoqëri publike ose operatorë mbetjesh.	- Të zhvillojë një Strategji për Ngritjen e Kapaciteteve. - Të përgatisë materiale dhe mjete të personalizuar trajnimi. - Të dorëzojë punëtori trajnimi dhe sesione praktike. - Të vlerësojë rezultatet e trajnimit dhe të propozojë rekomandime.
2.	Ekspert i lartë Financiar	2	- Diplomë Master në Financë ose Ekonomi - 5 vjet eksperiencë të veçantë/të kombinuar si ekspert i Financave Vendore; eksperiencia në sektorin e mbetjeve përbën vlerë të shtuar. - Minimumi 3 vjet eksperiencë në dorëzimin e trajnimeve dhe ngritjen e kapaciteteve. - Duhet të ketë aftësi të mira komunikimi në gjuhën angleze.	- Të vlerësojë kostot kapitale dhe operative për masat e parashikuara në PMMB/PMMB-të (Planet e Menaxhimit të Mbetjeve Bashkiake). - Të këshillojë bashkitë për buxhetimin dhe planifikimin financiar. - Të identifikojë burimet e mundshme të financimit (vendore, kombëtare, donatorë). - Të propozojë mekanizma të qëndrueshëm për rikuperimin e kostove. - Të zhvillojë tregues të performancës financiare dhe mjete monitorimi.
3.	Ekspert i lartë i menaxhimit të mbetjeve të ngurta	2	- Diplomë Master në Inxhinieri Mjedisore, Shkenca Mjedisore ose ekuivalente. - Minimumi 10 vjet eksperiencë në planifikimin dhe operimin e sistemeve të menaxhimit të mbetjeve të ngurta (SWM). - 7 vite eksperiencë të veçantë/të kombinuar si ekspert i SWM-së/në aktivitete trajnimi dhe ngritje	- Të analizojë shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta (SWM) dhe të hartojë analiza dhe raporte përkatëse. - Të asistojë në hartimin e Planeve të Menaxhimit të Mbetjeve (PMM/PMMB), rregulloreve dhe planeve operationale. - Të zhvillojë dhe të dorëzojë

Konsulenti do të angazhojë, sipas nevojës, edhe ekspertë të tjerë të rinj dhe staf mbështetës me eksperiencën dhe sfondin e kërkuar, në mënyrë që të arrihen objektivat dhe të përmbushet shtrirja e kësaj detyre. Kjo përfshin stafin mbështetës dhe pika lokale kontakti në nënrajonet Vlorë Jug dhe Gjirokastrë, për të lehtësuar organizimin e aktiviteteve, për të mbajtur kontakt të përditshëm me bashkitë dhe për të mbledhur të dhënat dhe informacionin e nevojshëm.

Aplikantët do të vlerësohen me qëllim përcaktimin e një liste të shkurtër që përfshin shoqëritë më të kualifikuara. Kriteret që do të përdoren për hartimin e listës së shkurtër do të jenë si më poshtë:

- Veprimtaria kryesore dhe vitet në treg – 30 pikë;

- Eksperienca e mëparshme në detyra të ngjashme – 60 pikë;

- Disponueshmëria e stafit të kualifikuar brenda shoqërisë për kryerjen e detyrës – 10 pikë;

- CV-të e ekspertëve kyç nuk do të vlerësohen gjatë procesit të hartimit të listës së shkurtër.

CV-të e ekspertëve kyç do të vlerësohen pas lëshimit të kërkesës për propozime (RFP) për Konsulentët e përfshirë në listën e shkurtër. Vlerësimi do të kryhet në përputhje me kriteret e vlerësimit të përcaktuara dhe të detajuara në kërkesën për propozime.

VI. Afati kohor për përfundimin e detyrave dhe dorëzimeve

Planifikimi i përgjithshëm dhe afatet për gurët kilometrikë dhe dorëzimet janë të lidhura ngushtësisht me kuadrin e zbatimit të EPBI-së dhe treguesit përkatës. Kontraktori duhet të respektojë manualin EPBI dhe, në koordinim me strukturat e EPBI-së, të paraqesë dhe të miratojë një tabelë të përditësuar të dorëzimeve. Tabela më poshtë është orientuese, në përputhje me gjendjen aktuale të projektit të projektit.

Afati kohor për përfundimin e detyrave dhe dorëzimeve				
Fusha	ID	Dorëzimet	Përshkrimi i dorëzimit	Afati (muaji)
Faza e <i>Inception</i> -it	D0	Raporti i <i>Inception</i> -it dhe plani i detajuar i punës/trajnitimit	Metodologjia, grupimi i bashkive në <i>coborte</i> , grafiku <i>Gantt</i> , sigurimi i cilësisë (QA), rreziqet, analiza e nevojave për trajnim (TNA), harta e palëve të interesuara, kalendari i raportimit.	3
A. Menaxhimi i të dhënave	A1	Raporti i vlerësimit të boshllëqeve të sistemeve të të dhënave për mbetjet	Vlerëson mbledhjen/raportimin e të dhënave bashkiake kundrejt VKM-së nr. 538/2021 dhe standardeve të BE-së, duke identifikuar boshllëqet dhe përmirësimet e rekomanduara.	6
A. Menaxhimi i të dhënave	A2	Protokollet dhe modelet për mbledhjen e të dhënave bashkiake	Procedura të standardizuara, formularë dhe modele digjitale të përafuara me VKM-në nr. 538/2021 (dhe ndryshimet e pritshme) për flukset e mbetjeve bashkiake, tregtare, ndërtimore, të rrezikshme dhe të riciklueshme.	8
A. Menaxhimi i të dhënave	A3	Paketa e mjeteve për mbledhjen e të dhënave në terren për EPBI	Mjete, lista kontrolli dhe formularë raportimi për stafin bashkiak për të mbledhur dhe dorëzuar në mënyrë të qëndrueshme të dhëna të rëndësishme për EPBI-në.	10
A. Menaxhimi i të dhënave	A4	Paketa e pajtimtarisë për statistikat vjetore të mbetjeve	Udhëzues, kalendar dhe modele për t'u mundësuar bashkive përgatitjen dhe dorëzimin e raporteve vjetore të statistikave të mbetjeve pranë AKM-së/AKEM-së deri më 31 janar të çdo viti.	Vjetore
A. Menaxhimi i të dhënave	A5	Kuadri i raportimit të të dhënave për AKM-në/AKEM-në	Kuadër monitorimi me tregues të përcaktuar të performancës, të lidhur me Direktivën Kornizë të BE-së për Mbetjet, Planin e Veprimit për Ekonominë Qarkulluese dhe efektivitetin e EPBI-së.	12
A. Menaxhimi i të dhënave	A6	Kuadri i monitorimit dhe verifikimit të përafuar me EPBI-në	Fjalor treguesish (përkufizime, formula, burime), kontrolle cilësie të të dhënave dhe procedura verifikimi, që lidhin performancën bashkiake me pranueshmërinë dhe shpërblimet në EPBI.	12
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B1	Raporti i <i>Inception</i> -it për ngritjen e kapaciteteve dhe kalendari gjithëpërfshirës i trajnimeve	Orar i konsoliduar 36-mujor dhe raport nisës që liston çdo trajnim/punëtori të planifikuar (modulet, objektivat, grupet, mënyrën e dorëzimit, gjuhën, trajnerët, vendet dhe gurët kilometrikë të M&V).	0–2
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B2	Paketa e trajnimit për Zbatimin e EPBI-së	Tërësi materialesh (prezantime, ushtrime, udhëzues për trajnerët) që u mundëson bashkive të operojnë EPBI, të mbledhin/raportojnë të dhëna, të kalojnë verifikimin dhe të kuptojnë llogaritjen e shpërblimeve.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B3	Klinika dhe paketa e mjeteve për zhvillimin e PMMB-ve	Punëtori praktike me modele dhe lista kontrolli që trajnojnë bashkitë për hartimin/përditësimin e PMMB-ve, në përputhje me kërkesat shqiptare/BE dhe Manualin EPBI.	Vazhdimisht

B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B4	Paketa e trajnimit për analizën e të dhënave dhe shërbimeve të mbetjeve	Sesione dhe mjete pune për sasinë/përbërjen e mbetjeve, auditimin e kontejnerëve/flotës, hartëzimin e mbulimit të shërbimit dhe identifikimin e pikave kritike mjedisore.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B5	Punëtori mbi parashikimin dhe planifikimin e infrastrukturës	Sesione ngritjeje kapacitetesh për stafin bashkiak mbi projeksionet e popullsisë dhe sasisë së mbetjeve, vlerësimin e nevojave për infrastrukturë dhe planifikimin për bashkëpunim ndërbashkiak.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B6	Kurs për digjitalizimin me GIS dhe projektimin e itinerareve	Trajnime praktike për stafin teknik bashkiak në përdorimin e GIS-së për ofrim efikas të shërbimit, përpunim të të dhënave hapësinore dhe menaxhimin e infrastrukturës së mbetjeve.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B7	Trajnim për menaxhimin financiar vendor në SWM	Punëtori për stafin financiar dhe administrativ mbi llogaritjen e kostove, parimet e përcaktimit të tarifave, identifikimin e burimeve të financimit dhe zbatimin e sistemeve të monitorimit financiar.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B8	Trajnim për angazhimin e palëve të interesuara dhe pjesëmarrjen publike	Sesione interaktive dhe materiale trajnime mbi praktikën më të mira të angazhimit të palëve të interesuara, pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes së komunitetit në menaxhimin e mbetjeve.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B9	Trajnim mbi parimet dhe zbatimin e ekonomisë qarkulluese	Trajnime të specializuara dhe materiale mbështetëse për të ndërtuar kapacitete bashkiake për të kuptuar, për të promovuar dhe për të zbatuar qasje të ekonomisë qarkulluese, në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B10	Trajnim për monitorimin e mbetjeve detare	Programe ngritjeje kapacitetesh për të përmirësuar aftësitë e bashkive për monitorimin e mbetjeve detare përmes menaxhimit më të mirë të mbetjeve në tokë.	Vazhdimisht
B. Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi institucional	B11	Trajnim për raportimin dhe Monitorimin e të dhënave të mbetjeve	Trajnime dhe materiale mbështetëse për stafin bashkiak për menaxhimin, përpunimin dhe raportimin efektiv të të dhënave të menaxhimit të mbetjeve.	Vazhdimisht
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C1	Planet draft të menaxhimit të mbetjeve bashkiake (PMMB/WMPs)	PMDB draft për çdo bashki, të strukturuar sipas hierarkisë së mbetjeve dhe direktivave të BE-së, duke integruar parandalimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin.	20
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C2	Planet përfundimtare të menaxhimit të mbetjeve (pas konsultimit)	PMDB të konsoliduara që integrojnë komentet dhe janë gati për miratim, me orare zbatimi, tregues kyç dhe plane financimi.	26
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C3	Vlerësim bazë bashkiak dhe analiza e flukseve të Materialeve	Profil i sasisë, përbërjes, flukseve të mbetjeve, mbulimit të shërbimit dhe infrastrukturës ekzistuese, për të udhëhequr ndërhyrjet e ekonomisë qarkulluese.	12
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C4	Set treguesish të ekonomisë Qarkulluese dhe integrimi në planifikim	Set treguesish (p.sh.: % e mbetjeve të ricikluara, % e mbetjeve organike të mbledhura veçmas/kompostuara, % e devijuar nga venddepozitimi) të integruar në mjetet lokale të planifikimit dhe monitorimit.	18
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C5	Analiza e boshllëqeve të infrastrukturës dhe katalogu i nevojave për investime	Inventar në nivel bashkie i deficitit të aseteve dhe listë e prioritetizuar e aseteve (kontejnerë, automjete, MRFs, kompostim, qendra <i>drop-off</i> dhe qendra ripërdorimi).	10
C. Mbështetje për	C6	Skicat e sistemeve të grumbullimit të	Sisteme lokale të përshtatura për grumbullim të veçuar, të dizajnuara sipas	18

tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese		veçuar (urban/rural)	kontekstit urban dhe rural.	
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C7	Paketa e llogaritjes së kostove dhe përcaktimit të tarifave	Analizë e kostove dhe dokumente politike për tarifat, në përputhje me kuadrin rregullator kombëtar dhe parimin e mbulimit të kostove.	16
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C8	Paketa e zbatimit të komunikimit dhe ndryshimit të sjelljes	Strategji komunikimi dhe mjete për zbatimin efektiv të PMMB-ve lokale.	12
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C9	Planet e investimeve për infrastrukturën prioritare	Specifikime teknike dhe plane investimi për projektet infrastrukturore prioritare (impiante për reduktimin e mbetjeve, qendra rikuperimi materialesh), me fokus efikasitetin mjedisor dhe operacional.	20
C. Mbështetje për tranzicionin drejt ekonomisë qarkulluese	C10	Raportet e vlerësimit strategjik mjedisor (VSM/SEA)	Raporte SEA të përgatitura për PMMB-të, duke siguruar pajtueshmëri me legjislacionin kombëtar dhe integrimin e masave të qëndrueshmërisë.	18
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D1	Vlerësim bazë financiar i menaxhimit të Mbetjeve (për çdo bashki)	Dokumenton strukturën e kostove, shpërndarjen e shpenzimeve dhe treguesit e efikasitetit të kostove për të vendosur pikën fillestare për përmirësim financiar.	8
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D2	Analiza e të ardhurave dhe boshllëqeve në Rikuperimin e kostove	Hartëzon të gjitha burimet e të ardhurave, kuantifikon boshllëkun drejt mbulimit të plotë të kostove dhe përcakton opsionet për mbylljen e tij.	10
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D3	Kuadri i TARIFAVE me analizë të përballueshmërisë dhe barazisë	Propozon modele tarifimi të bazuara në kosto me skenarë dhe mekanizma mbrojtës, duke vlerësuar përballueshmërinë dhe efektet shpërndarëse.	12
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D4	Plani për përmirësimin e faturimit dhe mbledhjes + mjetet e monitorimit	Diagnostikon sistemet aktuale të faturimit/mbledhjes, propozon përmirësime procesesh dhe sistemesh dhe ofron instrumente për monitorim të vazhdueshëm.	14
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D5	Program trajnimi për financat e SWM (buxhetim, planifikim, tarifa, të ardhura)	Dorëzon module praktike, ushtrime dhe mjete pune për ngritjen e kapaciteteve bashkiake në planifikimin financiar dhe menaxhimin e të ardhurave.	18–24
D. Forcimi i qëndrueshmërisë financiare të SWM-së	D6	Set treguesish të performancës financiare dhe shënim mbi integrimin në EPBI	Përcakton KPI-të, burimet e të dhënave dhe objektivat dhe sqaron mënyrën si integrohen në monitorimin e EPBI-së dhe kriteret e pranueshmërisë.	16
